



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

**RAPORT I VITIT 2021 PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK TË  
REALIZUAR NGA MINISTRIA E KULTURËS**

**1. Përmbledhje ekzekutive**

Gjatë vitit 2021, Ministria e Kulturës nuk ka kryer procesin e konsultimit publik për asnjë nga aktet e miratuara duke qenë se këto akte nuk plotësonin kushtet për t'iu nënshtruar këtij procesi sipas ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

**2. Analiza e konsultimeve të kryera në vitin 2021**

*Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike*

Gjatë 2021 Ministria e Kulturës ka miratuar gjithsej 8 Vendime të cilat për shkak të natyrës së tyre nuk ndodheshin në kushtet për t'iu nënshtruar konsultimit publik duke qenë se nuk janë akte për të cilat kërkohet detyrimisht konsultimi publik, sipas legjislacionit në fuqi.

Ligji nr. 146/2014 rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projekt-dokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik dhe asnjë nga aktet e miratuara nga Ministria e Kulturës nuk hyn në kategoritë e përmendura më sipër.

Më poshtë renditen aktet e miratuara gjatë vitit 2021 duke parashtruar se përse këto akte nuk i janë nënshtruar konsultimit publik.

1. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 220, datë 7.4.2021 “Për kushtet e posaçme të lëshimit të lejes, dokumenatve shoqërues, si dhe procedurat për shqyrtimin ose revokimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike”;
2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.583, date 6.10.2021 “Për procedurat e krijimit dhe administrimit të bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura”;
3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.725, datë 24.11.2021 “Për funksionimin, organizimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Muzeut Kombëtar të Pavarësisë” ;
4. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 97, datë 17.02.2021 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 729 datë 16.09.2020 të Këshillit të Ministrave "Për deklarimin pasuri kulturore "Qendër historike" të fshatit Kaninë, zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”;

5.Vendim nr. 146, datë 10.03.2021 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Muzeut të Arsimit Korçë”;

6.Vendim nr. 199, datë 31.03.2021 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kushteve të posaçme të licencimit, dokumentet shoqëruese, procedurat për shqyrtimin ose revokimin e licencës, tarifatat e aplikimit dhe të kuotizacionit vjetor për ushtrimin e veprimtarisë tregtare të pasurive kulturore”;

7.Vendim nr. 220, datë 07.04.2021 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave për hulumtimet arkeologjike, të kushteve të posaçme të lëshimit të lejes, dokumenteve shoqëruese, si dhe procedurave për shqyrtimin ose anulimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike”;

8.Vendim nr. 329, datë 02.06.2021 i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në vendimin nr. 792, datë 7.10.2020 të Këshillit të Ministrave, "Për caktimin e kushteve dhe të kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive e licencave, procedurave për dhënien, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionin vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale" .

**Aktet e përmendura më sipër, nuk i nënshtrohen procesit të konsultimit publik pasi nuk janë objekt i ligjit . Konkretisht, aktet e miratuara nuk bëjnë pjesë tek ajo kategori aktesh të parashikuara në pikën 1, të nenit 1 të ligjit 146/2014 për të cilët kërkohet detyrimisht realizimi i procesit të konsultimit publik.**

Gjatë vitit 2021, Ministria e Kulturës ka realizuar procesin e konsultimit publik për 1 (një) projektligj: “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to””. Nga analiza e kryer pas përfundimit të konsultimeve rezulton që ka një numër të lartë të komenteve/sugjerimeve nga publiku.

Kemi marrë komente/sugjerime nga shumë palë të interesuara, të ardhura kryesisht nëpërmjet takimeve të grupeve të punës dhe komenteve/sugjerimeve të ardhura me postë/email. Një pjesë e mirë e këtyre komenteve/sugjerimeve janë përfshirë në procesin e vendimmarrjes, duke u integruar në tërësi në përmbajtjen e projektligjit.

Nga monitorimi i regjistrimit elektronik të konsultimit publik, rezulton se nuk ka ardhur koment në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve Publike.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”” u dërgua në Këshillin e Ministrave, i cili e ktheu për rishikim me komentet përkatëse. Lidhur me arsyet e kthimit, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në bashkëpunim me Drejtorinë e Drejtës së Autorit, kanë raportuar tek Kabineti dhe Sekretari i Përgjithshëm. Drejtoria e Drejtës së Autorit, ka hartuar shkresën për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, të cilët kanë shprehur dakortësinë për draftin e projektligjit për të drejtat e autorit.

Në përfundim të hapave proceduralë, paketa e plotë ligjore është ridërguar në Kryeministri dhe në datën 18 nëntor 2021, projektligji është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Në datën 15.02.2022 Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik do të diskutojë rreth projektligjit *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”*.